

Banka e Shqipërisë

TENDENCAT NË KREDITIM T3 - 2018

Olta Manjani dhe Medvin Shehu
Departamenti i Politikës Monetare, Banka e Shqipërisë

TETOR 2018

Pikëpamjet e shprehura në këtë material janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bankës së Shqipërisë.

P Ë R M B A J T J A

<i>Hyrje</i>	4
<i>Përmbledhje</i>	5
<i>1. Kredia për biznese</i>	6
<i>2. Kredia për individë</i>	8
<i>3. Ecuria e normave të interesit dhe kushtet e tjera të kreditimit</i>	10
<i>4. Tendencat e kreditimit në vendet e rajonit</i>	14

HYRJE

Ky material synon të paraqesë një panoramë të tendencave të aktivitetit kreditues në vend. Për të përmbushur këtë qëllim, materiali analizon të dhënat monetare për portofolin e kredisë, si dhe kushtet e kreditimit. Gjithashtu, pjesë e këtij materiali është edhe një përmbledhje e zhvillimeve të fundit të aktivitetit kreditues në vendet e Evropës Qendrore Juglindore (EQJL).

Statistikat kryesore të analizuar në këtë material janë:

- *të dhënat për aktivitetin kreditues të bankave për sektorin rezident të ekonomisë;*
- *të dhënat cilësore të marra nga vrojtimi i aktivitetit kreditues;*
- *statistikat për çmimin e kredisë, si në monedhën vendase ashtu edhe në euro;*
- *të dhënat monetare për vëllimin e kredisë për vendet e rajonit. Vendet e përfshira në analizë janë: Bullgaria (BU), Kroacia (Cr), Rumania (RO), Serbia (Sr), Polonia (Pl), Hungaria (Hu), Republika Çeke (CZ), Maqedonia (IRJM).*

Materiali mbulon të dhënat e publikuara deri më 26 tetor 2018, të cilat përfshijnë informacion për të dhënat monetare dhe financiare në vend deri në muajin shtator 2018, dhe të dhënat e vrojtimit të aktivitetit kreditues për tremujorin e tretë të vitit 2018. Të dhënat e kredisë për vendet e rajonit janë deri në muajin gusht 2018.

PËRMBLEDHJE

Kredia për sektorin privat vlerësohet në rreth 35.3% të PBB-së në fund të tremujorit të tretë të vitit. Ky tregues shfaqet në rënie nga një vit më parë, duke reflektuar rritjen e moderuar të kredisë, sidomos në segmentin e bizneseve. Zhvillimet sipas monedhave tregojnë për rritje më të lartë të kredisë në lekë, megjithëse zgjerimi i këtij portofoli ka ndjekur një trajektore ngadalësuese. Megjithatë, kredia në valutë vijon të dominojë portofolin e kredisë për sektorin privat, ku në fund të tremujorit të tretë të vitit, ajo përbën rreth 54% të totalit të kredisë për sektorin privat.

Kredia për biznese përbën pjesën më të madhe të portofolit të kredisë për sektorin privat. Në terma të PBB-së, raporti i saj vlerësohet në rreth 23.2%, në zvogëlim nga një vit më parë. Në një këndvështrim më afatgjatë, ecuria e kredisë për biznese vijon të mbetet e paqëndrueshme. Zhvillimet në këtë portofol kushtëzohen nga kërkesa e ulët e biznesit për kredi, si dhe nga kushtet relativisht të shtrënguara të kreditimit në këtë segment.

Kredia për individë shfaq rritje të qëndrueshme, pavarësisht peshës më të ulët në tepicën e kredisë për sektorin privat. Si raport ndaj PBB-së, ky portofol vlerësohet në rreth 12.1% në fund të tremujorit të tretë të vitit, thuhet i pandryshuar nga një vit më parë. Ecuria e kredisë për individë mbështetet nga kërkesa e lartë e tyre për financim, në linjë me kushtet vazhdimisht të lehtësuara të kreditimit në këtë segment.


Normat e interesit të kredisë së re në lekë kanë mbetur në nivele të ngjashme me ato të vitit 2017 për bizneset, dhe janë ulur lehtësisht për individët. Ulja e fundit e normës bazë të interesit në muajin qershor duket të jetë transmetuar vetëm në segmentin e kredisë për blerje banese. Kushtet joçmim të kredisë janë shtrënguar për bizneset dhe janë lehtësuara për individët, duke konfirmuar politikat shtrënguese të bankave në kreditimin e bizneseve dhe standarde të lehtësuara të tyre për kredinë e individëve.

Aktiviteti kreditues në vendet e rajonit të EQJL-së vijon të reflektojë segmentimin e dukshëm gjeografik, por edhe atë midis segmenteve të tregut. Kredia për sektorin privat ndaj PBB-së luhet në intervalin 26%-55%, nga vendi me raportin më të ulët (Rumania) në atë me raportin më të lartë (Kroacia), përkatësisht, në fund të gjysmës së parë të vitit 2018. Kredia për sektorin privat ka rezultuar relativisht e qëndrueshme në muajt korrik dhe gusht. Kërkesa për kredi vijon të mbetet e lartë, kundrejt kushteve relativisht të shtrënguara të kreditimit. Kjo kërkesë ka ruajtur normat e rritjes së një tremujori më parë, si në segmentin e kredisë për biznese, edhe në atë për individë.

1. KREDIA PËR BIZNESE


Kredia për sektorin privat vlerësohet në rreth 35.3% ndaj PBB-së, në fund të tremujorit të tretë të vitit. Ky raport shfaqet në një trajektore rënëse. Krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë, kredia për sektorin privat ndaj PBB-së ka shënuar tkurrje me rreth 1.3 pikë përqindje, duke evidentuar performancën relativisht të dobët të kredisë për biznese gjatë kësaj periudhe. Raporti i saj ndaj PBB-së vlerësohet në rreth 23.2% në fund të muajit shtator, ngjashëm me një tremujor më parë, por rreth 1.3 pikë përqindje më i ulët se në tremujorin e tretë të vitit të kaluar.

Në një këndvështrim afatgjatë, rritja e moderuar e kredisë për biznese në vitet e fundit është ndikuar si nga faktorë të kërkesës, ashtu edhe nga faktorë të ofertës. Nga njëra anë, kërkesa e bizneseve për financim ka rezultuar e paqëndrueshme, duke iu përgjigjur nga ana tjetër kushteve relativisht të shtrënguara të kreditimit për këtë segment.



Kredia për biznese tregon për ecuri relativisht të qëndrueshme të shpërndarjes së saj sipas sektorëve të ekonomisë. Portofoli i kredisë për biznese dominohet nga kredia për sektorin "Tregti, hotele dhe restaurante". Ky portofol përbën rreth 45% të tepricës së kredisë për sektorin privat në fund të tremujorit të tretë të vitit dhe ndiqet nga kredia për sektorin e industrisë, me rreth 23.7%. Portofolet e kredisë për sektorin e ndërtimit dhe "shërbimet e tjera" përbëjnë përkatësisht 14.6% dhe 15.2% të kredisë në total. Sektori më pak i kredituar në ekonomi mbetet ai i bujqësisë, për shkak të shkallës së ulët të formalizimit, rrezikut të lartë dhe vetë problematikës që e karakterizon këtë sektor.

Grafik 2. Kredia për biznese sipas monedhës dhe qëllimit të përdorimit



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Në terma të monedhës, portofoli i kredisë për biznese dominohet nga kredia në valutë, por pesha e saj ka ardhur në zvogëlim në terma afatgjatë. Megjithatë, kredia në valutë zë peshën kryesore në tepricën e kredisë për biznese, me rreth 61.7% në fund të tremujorit të tretë të vitit. Orientimi i kërkesës së bizneseve për kredi në monedhë të huaj lidhet me natyrën dhe llojin e aktivitetit të biznesit. Pesha e kredisë për biznese në lekë ndaj kredisë në total për biznese rezultojnë në rreth 38.3% në fund të tremujorit të tretë, ngjashëm me tremujorin e kaluar.

Kredia për biznese sipas qëllimit të përdorimit evidenton tepricë më të lartë të kredisë për investime. Ky portofol përbën rreth 38% të totalit të kredisë për sektorin privat. Ecuria e këtij portofoli konfirmon rritje të ulët, por të qëndrueshme në terma vjetorë. Kredia për qëllime likuiditeti zë një peshë prej 28% të kredisë në total për sektorin privat. Ky portofol karakterizohet përgjithësisht nga ecuria e luhatshme, në varësi të nevojave sezonale të bizneseve për likuiditet. Kredia për likuiditet ka reduktuar peshën e saj kundrejt një viti më parë me rreth 1.6 pikë përqindje, ndërsa kredia për investime e ka rritur atë me 0.4 pikë përqindje për të njëjtën periudhë.

2. KREDIA PËR INDIVIDË

Kredia për individë vlerësohet në rreth 12.1% si raport ndaj PBB-së në fund të tremujorit të tretë të vitit, duke ruajtur peshë të ngjashme me një vit më parë. Ecuria e këtij portofoli shfaqet relativisht e qëndrueshme. Në një këndvështrim afatgjatë, zhvillimet pozitive në këtë segment janë mbështetur nga rritja e vazhdueshme e kërkesës, e cila ka reaguar në vijim ndaj kushteve të lehtësuara të kreditimit për këtë segment. Megjithatë, financimi i këtij segmenti me mjete monetare nga sistemi bankar vijon të mbetet i ulët, krahasuar edhe me vendet e rajonit¹.


Grafik 3. Kredia për individë, ndaj PBB-së dhe sipas monedhave



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në terma të monedhës, ndryshe nga kredia për biznese, portofoli i kredisë për individë dominohet nga kredia në lekë. Në fund të tremujorit të tretë, kredia në monedhë vendase përbën rreth 61.5% të tepricës së kredisë për individë. Krahasuar me një vit më parë, ky raport është rritur me 2.8 pikë përqindje. Në terma më afatgjatë, orientimi i kreditimit në monedhë vendase reflekton, ndër të tjera, kërkesën në rritje të individëve për financim në monedhë vendase. Si një segment – në pjesën më të madhe të tij – pa mbrojtje natyrale ndaj kursit të këmbimit, kërkesa në rritje pasqyron në vijim ndërjegjësimin e individëve mbi rreziqet e ekspozimit ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit. Nga ana tjetër, kjo sjellje është mbështetur nga politikat e kreditimit të vetë bankave, si dhe masat e marra nga Banka e Shqipërisë për nxitjen e kreditimit në lekë.

Grafik 4. Kredia për individë sipas monedhës dhe qëllimit të përdorimit




Burimi: Banka e Shqipërisë.

¹ Për një analizë krahasuese më të detajuar të kredisë sipas segmenteve të tregut referojuni seksionit të fundit të këtij materiali, mbi tendencat e kreditimit në vendet e rajonit.

Sipas qëllimit të përdorimit, pjesa më e madhe e kredisë së dhënë nga sektori bankar përbëhet nga kredia hipotekare dhe një pjesë më e vogël shkon për financimin e konsumit. Në fund të tremujorit të tretë të vitit, kredia hipotekare përbën rreth 69.2% të kredisë totale të dhënë për individët. Kredia konsumatore ka peshë më të ulët në tepricën e kredisë për individë, rreth 30.8%. Megjithatë, ky është një portofol që ka shënuar rritje të shpejtë vitet e fundit. Pesha e tij ndaj kredisë për sektorin privat është zgjeruar me rreth 0.9 pikë përqindje nga e njëjta periudhë e vitit të kaluar.

3. ECURIA E NORMAVE TË INTERESIT DHE KUSHTET E TJERA TË KREDITIMIT

Norma mesatare e interesit për kreditë në lekë dhënë bizneseve private u rrit lehtas në tremujorin e tretë të vitit; ajo rezultoi 6.6%, nga 6.4% që shënonte në tremujorin paraardhës. Interesat janë rritur për të dyja kategoritë, si për kredinë për likuiditet, ashtu edhe për atë për investime. Tek interesat e kredisë për likuiditet ka qenë ajo për kapital qarkullues e cila ka ndikuar me shumë në rritje². Interesat e kredisë për investime janë rritur gjithashtu, duke eliminuar uljen e shënuar një tremujor më parë³. Normat e interesit të kredisë dhënë bizneseve, këtë tremujor duken të kenë frenuar prirjen rënëse të vërejtur në tremujorin e mëparshëm. Krahasuar me një vit më parë, ato luhaten në nivele të ngjashme.




Normat e interesit për kreditë në euro të bizneseve nuk kanë ndryshuar në tremujorin e tretë, duke rezultuar 4.3% ashtu si në tremujorin e dytë të vitit (Grafik 6). Sipas qëllimit të përdorimit të kredisë, ulja e interesave tek kredia për likuiditet ka kompensuar rritjen e tyre tek kategoria e investimeve. Në krahasim me një vit më parë, interesat e kredisë në euro gjenden lehtas më lart.

² Norma e interesit për kredinë për likuiditet rezultoi 6.8% në tremujorin e tretë të vitit, nga 6.7% në tremujorin e mëparshëm. Një vit më parë ajo ishte 7.0%.


³ Interesi mesatar i kredisë për investime shënoi respektivisht 5.9%, 5.1% dhe 6.0% në tre tremujorët e këtij viti. Një vit më parë ai ishte 5.7%.

Grafik 6. Ecuria e normave të interesit për kreditë në euro për bizneset private



Bankat mbeten të kujdesshme në kreditimin e bizneseve. Krahas normave më të larta të interesit për segmente të caktuara të kredisë, bankat, edhe këtë tremujor, vijojnë të kenë kushte joçmim të shtrënguara (Grafik 7). Ndër to, forcimi i kërkesave për kolateral, madhësia dhe maturiteti i kredisë mbeten elementet kryesore nëpërmjet të cilave bankat shprehin përqasjen e tyre konservatore ndaj bizneseve.


Grafik 7. Ecuria e kushteve të kreditimit për bizneset, balancë përgjigjesh, pp



Shënim: Balancat pozitive/negative nënkuptojnë lehtësim/shtrëngim të kushteve. Kushtet çmim dhe ato joçmim janë llogaritur si mesatare e thjeshtë e balancave të përbërësve individualë.


Normat e interesit për kreditë në lekë për individë në tremujorin e tretë kanë shënuar rritje të lehtë (Grafik 8). Interesi mesatar për kreditë për individë shënoi 7.1% në këtë tremujor nga 6.9% në tremujorin e dytë. Sipas qëllimit të përdorimit, në këtë tremujor dallohet kontributi i rritjes së interesave për kredinë konsumatore (8.4 %, nga 8.1% tremujorin e dytë) në rritjen e interesit mesatar. Normat e interesit për kreditë hipotekare, ndërkohë, kanë regjistruar ulje të lehtë nga tremujori i kaluar dhe gjenden më poshtë se një vit më parë.

Grafik 8. Ecuria e normave të interesit për kreditë në lekë për individët




Ecuri të njëjtë ka treguar edhe norma mesatare e kredive në euro për individë, duke rezultuar në rritje këtë tremujor (Grafik 9). Interesi mesatar i kredisë për individë në euro rezultoi 3.8% në tremujorin e tretë, nga 3.5% një tremujor më parë. Rritja është ndikuar nga ecuria e interesave për kredi hipotekare (rritëse), ndërkohë që interesat e kredisë konsumatore janë ulur. Krahasuar me një vit më parë, interesat për kredi konsumatore edhe hipotekare janë më të ulëta.

Grafik 9. Ecuria e normave të interesit për kreditë në euro për individët



Ndryshe nga bizneset, bankat kanë qenë më pozitive në kreditimin e individëve, duke vijuar edhe në tremujorin e tretë të këtij viti me lehtësim kushtesh (Grafik 10). Kushtet joçmim të aplikuara për kreditë për individë janë lehtësuar ose nuk kanë ndryshuar në krahasim me tremujorin e mëparshëm. Kështu, ato kanë lehtësuar kërkesat për kolateral dhe kanë mbajtur të pandryshuar maturitetin maksimal të kredisë. Madhësia e kredisë shfaqet lehtësisht më e shtrënguar se një tremujor më parë.

Grafik 10. Ecuria e kushteve të kreditimit për individët




Burimi: Banka e Shqipërisë, Vrojtimi i Aktivitetit Kreditues, Tetor 2018.
Shënim: Balancat pozitive/negative nënkuptojnë lehtësim/shtrëngim të kushteve. Kushtet çmim dhe ato joçmim janë llogaritur si mesatare e thjeshtë e balancave të përbërësve individualë.


4. TENDENCAT E KREDITIMIT NË VENDET E RAJONIT

Kredia për sektorin privat ka shënuar rënie ndaj PBB-së në pjesën më të madhe të vendeve të rajonit të EQJL-së, krahasuar me vitin 2016. Ecuria në kohë e këtij raporti tregon se një pjesë e këtyre vendeve e ka kompensuar pjesërisht këtë rënie me rritjen e shënuar gjatë vitit 2017 dhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2018. Raporti i kredisë për sektorin privat ndaj PBB-së, në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit, luhetet nga vlera rreth 26% në rastin e Rumanisë, në rreth 55% në rastin e Kroacisë.

Analiza e kredisë sipas segmenteve të tregut tregon se në shumë prej vendeve, individët janë më të financuar nga sektori bankar sesa bizneset. Kështu, në Poloni, Kroaci, Republikë Çeke dhe Rumania, raporti i kredisë për individë ndaj PBB-së është dukshëm më i lartë, se ai i kredisë për biznese ndaj PBB-së. Në vende të tjera si Serbia apo Maqedonia, ky raport është ndjeshëm më i balancuar, ku bizneset rezultojnë me ekspozim më të madh në terma të financimit nga sistemi bankar. Në Shqipëri dhe Bullgari bizneset përdorin dukshëm një levë më të madhe financiare nga sektori bankar sesa individët. Raporti i kredisë për biznese ndaj PBB-së, krahasuar me atë të individëve, rezulton rreth 11.1 pikë përqindje dhe 10.6 pikë përqindje më i lartë, përkatësisht për Shqipërinë dhe Bullgarinë. Gjithashtu, vërehet se shumica e vendeve ku bizneset janë më të financuara nga sektori bankar, kanë raport në rënie të kredisë për biznese ndaj PBB-së dhe rritje të raportit të kredisë për individë. Kjo konfirmohet dhe nga normat e shpejta të rritjes së portofolit të kredisë për individë në rajon, e veçanërisht në këto vende.



Zhvillimet në terma më afatshkurtër tregojnë se kredia për sektorin privat në vendet e rajonit⁴ ka shfaqur norma të ngjashme rritjeje vjetore në muajt korrik dhe gusht, krahasuar me tremujorin e dytë të vitit. Norma mesatare vjetore e rritjes së këtij portofoli rezultoi e qëndrueshme në 3.9%. Sipas vrojtimit të aktivitetit kreditues në vendet e rajonit të EQJL-së⁵, kushtet e kreditimit janë përmirësuar në gjashtëmujorin e parë, por përballë një kërkesë shumë të fortë, hendeku midis kërkesës dhe ofertës është ende i lartë. Bankat shprehen për thellim të kësaj prirjeje në gjysmën e dytë të vitit. Pavarësisht ecurisë së qëndrueshme në terma mesatarë vjetorë, zhvillimet e kredisë në terma gjeografikë mbeten të segmentuara. Evropa Qendrore vijon të udhëheqë normat e rritjes, ndërsa rritja e kredisë në rajonin e Ballkanit ka ngadalësuar ritmin e saj, duke thelluar më shumë hendekun midis tyre.



Ecuria sipas segmenteve konfirmon rritjen e paqëndrueshme të kredisë për biznese (Grafik 13). Ky portofol u zgjerua mesatarisht me 3% vit mbi vit në muajt korrik dhe gusht, ngjashëm me tremujorin e dytë të vitit. Shpërndarja gjeografike tregon për zhvillime negative të këtij segmenti në rajonin e Ballkanit, i cili rezultoi në thellim më tej normat konkurruese. Kjo ka ndikuar dhe në ngadalësimin e përgjithshëm të kredisë në këtë rajon. Nga ana tjetër, kjo rënie kompensohet nga ecuria pozitive e kredisë për biznese në rajonin e Evropës Qendrore, e cila udhëheq rritjen e kredisë së këtij segmenti. Portofoli i kredisë për biznese në Shqipëri shënon norma të luhatshme, por pozitive rritjeje.


Kredia për individë në rajonin e EQJL-së shfaq përgjithësisht rritje më të shpejtë dhe më të qëndrueshme (Grafik 14). Ky portofol, në muajt korrik dhe gusht, ka shënuar një rritje mesatare vjetore me rreth 4.4%. Rajoni i Ballkanit është

⁴ Të dhënat e kredisë për sektorin privat, për efekt të analizës krahasuese, janë të rregulluara për kursin e këmbimit dhe inflacionin.

⁵ Vrojtimi i Aktivitetit Kreditues në rajonin e EQJL-së, për gjysmën e parë të vitit 2018, përfshin tremujorin e katërt të vitit 2017 dhe tremujorin e parë të vitit 2018, dhe gjendet në adresën e mëposhtme: http://www.eib.org/attachments/efs/economics_cesee_bls_2018_h1_en.pdf


ai që udhëheq normat e rritjes së këtij portofoli në rajonin e gjerë. Kredia për individë në Shqipëri është në linjë me ecurinë e këtij portofoli në rajonin e Ballkanit, duke përfshirë dhe prirjen ngadalësuese të muajve të fundit. Sipas vërtetimit të aktivitetit kreditues në rajonin e EQJL-së, kërkesa e individëve për kredi mbështetet si nga nevojat për financim për blerje banese, ashtu edhe nga financimi i konsumit.

Grafik 13. Ecuria e kredisë për biznese në vend dhe në rajon



Burimi: Bankat qendrore të vendeve përkatëse; llogaritje të autorëve.

Grafik 14. Ecuria e kredisë për individë në vend dhe në rajon



Burimi: Bankat qendrore të vendeve përkatëse; llogaritje të autorëve.